



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 117 Prot.

Tiranë, më 01.11 2016

VENDIM Nr. 120, datë 25.10.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 48, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 12 të datës 25.10.2016, pasi shqyrtoi *Relacionin mbi verifikimin në terren të gjetjeve arkeologjike* të konstatuara gjatë punimeve për zgjerimin e rrugës rurale Sukaxhi-Gjazuj, Njësia administrative Ungrej, Lezhë, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe DRKK Shkodër- Sektori Lezhë,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Relacionin mbi verifikimin në terren të gjetjeve arkeologjike* të konstatuara gjatë punimeve për zgjerimin e rrugës rurale Sukaxhi-Gjazuj, Njësia administrative Ungrej, Lezhë, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe DRKK Shkodër, Sektori Lezhë.
2. Bashkia Lezhë të depozitojë pranë ASHA projektin e Zgjerimit të rrugës rurale Sukaxhi-Gjazuj, Njësia administrative Ungrej, Lezhë.
3. Të kryhet nga ASHA dhe DRKK Shkodër-Sektor i Lezhë, dokumentimi i strukturave të mureve të zbuluara dhe të merren masat për rehabilitimin e zonës nga Bashkia Lezhë dhe DRKK Shkodër-Sektor i Lezhë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO



Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al